

ISOMAT AK-9

Ngjitës për pllaka

Përshkrimi

ISOMAT AK-9 është një ngjitës për pllaka me bazë çimentoje. Ajo ofron një forcë ngjitëse fillestare dhe përfundimtare të lartë, si dhe rezistencë ndaj lagështirës.

Ajo klasifikohet si ngjitës i llojit C1 sipas standardit EN 12004.

Fushat e përdorimit

ISOMAT AK-9 përshtatet për ngjitjen e pllakave qeramike në mure ose dysheme mbi sipërfaqe prej betoni, mur tulle, suva etj., në ambiente të brendshme ose të jashtme.

Të dhënat teknike

Trajta:	llaç çimentoje
Ngjyrat:	gri, e bardhë
Uji që nevojitet:	6,00-6,50 l/thes 25 kg
Temperatura e përdorimit:	nga +5°C deri +35°C
Trashësia e përdorimit:	deri në 10 mm
Koha e punueshmërisë:	të paktën 6 orë
Koha e mbajtjes hapur:	të paktën 20 minuta
Koha e mbajtjes hapur për riparime të vogla:	të paktën 30 minuta
Stukimi i fugave në mure:	pas 3-8 orësh
Stukimi i fugave në dysheme:	pas 24 orësh
Forca ngjitëse pas:	
• 28 ditësh:	≥ 1,00 N/mm ²
• ngrohjes në +70°C:	≥ 0,50 N/mm ²
• zhytjes në ujë:	≥ 0,50 N/mm ²
• 25 ciklesh ngrirje-shkrirje:	≥ 0,50 N/mm ²
Rezistenca ndaj temperaturave:	nga -15°C deri në +60°C

Të gjitha matjet janë kryer sipas standardit EN 12004.

Udhëzimet e përdorimit

1. Nënshtrësia

Sipërfaqja që do të mbulohet duhet të jetë e pastër, pa pluhur, graso, bojë, materiale të lira etj. Rekomandohet njomja e sipërfaqes përpara përdorimit.

2. Përdorimi

ISOMAT AK-9 hidhet gradualisht në ujë duke u trazuar vazhdimisht, derisa të krijohet një masë uniforme në trajtë brumi. Për përzierjen rekomandohet përdorimi i një mikseri me xhiro të ulëta.

Përzierja duhet të lihet rreth 5 minuta të stabilizohet dhe pastaj duhet të trazohet përsëri me ngadalë. Kola e pllakave duhet të shpërndahet ("e krehur") mbi sipërfaqe duke përdorur një mallë të dhëmbëzuar (krehër), me qëllim që të aplikohet në mënyrë uniforme në të gjithë sipërfaqen. Pllakat duhet të fiksohen duke u ngjeshur në pozicionin e dëshiruar.

Përzierja e përdorur duhet të mbulohet me pllaka brenda 20 minutash me qëllim që të evitohet formimi i "cipës", d.m.th. përpara se shtresa e ngjitëses të fillojë të mpikset.

Elastifikimi

Për veshjen me pllaka të sipërfaqeve të paqëndrueshme si pasojë e dridhjeve ose ndikimeve të tkurrjes-bymimit, si p.sh. pllakat e gipsit, pllakat e zdrukthit, dyshemetë me ngrohje nga poshtë, tarracat, ballkonet etj., është e nevojshme që kola e pllakave të elastifikohet nëpërmjet shtimit të deri në 3,15 kg ADIFLEX-B në 25 kg ISOMAT AK-9, plus një sasi uji në varësi të punueshmërisë së dëshiruar.

Konsumi

1,5-4,0 kg/m², në varësi të madhësisë së dhëmbëve të mallës dhe të natyrës së nënshtrësës.

Amballazhimi

ISOMAT AK-9 ofrohet në thasë letre 25 kg.

ISOMAT AK-9


Magazinimi

Afati i ruajtjes për përdorim, në thasë të izoluar dhe në ambiente të thata, është minimumi 12 muaj.


Shënime

- ISOMAT AK-9 përmban çimento dhe reagon si alkaline me ujin, kështu që klasifikohet si irritues.
- Sipërfaqet shumë poroze, si p.sh betoni i lehtë, pllakat e gipsit, pllakat e zdrukthit etj. duhet të lyhen fillimisht me astarin akrilik UNI-PRIMER.
- Shikoni rreziqet e përdorimit dhe këshillat për sigurinë që janë të shkruara mbi thes.

ISOMAT AK-9 GRI

	
ISOMAT S.A. 17 th km Thessaloniki – Ag. Athanasios P.O. BOX 1043, 570 03 Ag Athanasios, Greece 08	
EN 12004:2007+A1:2012 DoP No.: ISOMAT AK-9 GREY/1009-01 NB: 2032 Normal setting cementitious adhesive, for internal and external tiling.	
Reaction to fire	Class A1
Release of dangerous substances	See MSDS
Bond strength, as:	
- initial tensile adhesion strength	≥ 0.5 N/mm ²
Durability, for	
- tensile adhesion strength after heat ageing	≥ 0.5 N/mm ²
- tensile adhesion strength after water immersion	≥ 0.5 N/mm ²
- tensile adhesion strength after freeze thaw cycles	≥ 0.5 N/mm ²

ISOMAT AK-9 E BARDHË

	
ISOMAT S.A. 17 th km Thessaloniki – Ag. Athanasios P.O. BOX 1043, 570 03 Ag Athanasios, Greece 08	
EN 12004:2007+A1:2012 DoP No.: ISOMAT AK-9 WHITE/1010-01 NB: 2032 Normal setting cementitious adhesive, for internal and external tiling.	
Reaction to fire	Class A1
Release of dangerous substances	See MSDS
Bond strength, as:	
- initial tensile adhesion strength	≥ 0.5 N/mm ²
Durability, for	
- tensile adhesion strength after heat ageing	≥ 0.5 N/mm ²
- tensile adhesion strength after water immersion	≥ 0.5 N/mm ²
- tensile adhesion strength after freeze thaw cycles	≥ 0.5 N/mm ²

ISOMAT S.A.
 BUILDING CHEMICALS AND MORTARS
ZYRAT QENDRORE – FABRIKA:
 Kilometri i 17të i Autostradës Selanik-Aj. Athanasiu 570 03
 Tel. : +30 2310 576 002, Fax: +30 2310 576 029
www.isomat.al e-mail: support@isomat.eu